

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kushtetuesja rrëzoi kërkesën e PD-së për Avokatin e Popullit, reagon Bardhi
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/29/kushtetuesja-rrezoi-kerkesen-e-pd-se-per-avokatin-e-popullit-reagon-bardhi/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 15:30:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 15:27:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6855daabf90111c3777ebca415c6d319ca2b34783f24c948249624f9ec712a78
TEKSTI	bf4cddade779bf0c97a91a654bf472e11e35cf2174ffddbe685a81c9396b375d
PAMJA	074ea261fae9c00b784ad75e46c7a9acce043e771fe1d808767246b7b77cd80b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a794cbda074d5f37f0b95ee1bad50cb808efe9cd9b83e71ef542070296a44129
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	da6b05e5b6a4871f38e77322a1aea555a613f6543c156d05714d243b2008ce80
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a794cbda074d5f37f0b95ee1bad50cb808efe9cd9b83e71ef542070296a44129>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kushtetuesja rrëzoi kërkesën e PD-së për Avokatin e Popullit, reagon Bardhi

Aktualitet

Publikuar: 29/09/2026

f X



Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike lidhur me procedurën e zgjedhjes së Avokatit të Popullit.

Pas vendimit, ka reaguar kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, i cili e ka kundërshtuar arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese. Bardhi pretendon se në vendim janë shtrembëruar faktet lidhur me momentin kur PD-ja tërhoqi mbështetjen për kandidaturat.

Sipas Bardhit, PD-ja e ka tërhequr mbështetjen për kandidaturat më 5 dhjetor 2025, ndërsa Komisioni i Ligeve i ka verifikuar kandidaturat dhe i ka kaluar për votim në seancë plenare më 9 dhjetor 2025.

REAGIMI

Mund të kishin thënë thjesht "rrëzohet", për qëllime politike, pa pasur nevojë të mashtronin publikisht. Në çdo rast, çfarëdo lloj vendimi që do të merrte Gjykata Kushtetuese, ne do ta respektonim di të detyrueshëm për zbatim. Por mashtrimin publik nuk e respektojmë dot; përkundrazi, e përbuzim me përcmim.

Dënoj me forcë shtrembërimin e fakteve dhe provave nga Gjykata Kushtetuese. Një gjykatë që deformon faktet, humbet besueshmërinë.

Gjykata Kushtetuese, në njoftimin publik për arsyet e rrëzimit të kërkesës së Grupit Parlamentar të PD-së për paligjshmërinë e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, shprehet se: "Në rastin në shqyrtim, ky kusht ishte plotësuar në momentin e verifikimit nga Komisioni i Ligeve të kandidaturave dhe kalimin e tyre për votim

Me të lexuarat

Dosja
Sherbimit
Sekret: Si i
hapte dyert e
Portit të
Durrësit Liburn
Aliu, me urdhër
të Vlorë Hysë
Dorëheqja e

Ramës / Nata e
Çunit të Fahriut
si ministër i
Brendshëm dhe
pakti me Mulin

Analisti i 'Syrir'
Florjan Nuri
ndërtoi pallat
13-kate në
shkelje të lejes
Bë Vlorë
Biznesi i verës,

firma e
ndërtimit dhe
tenderat/ Si u
shumëfishua
pasuria e çiftit
Ergys-Dorina
Mësaži i

Oriela Nebiajt
për Gys Agasin,
fotot e Hatit,
emra suprizë,
roli i Mektrin
Motors dhe ç...

ne seance plenare. Ie kete menyre, procesi kishte sjelle pasoja konkrete, NDAJ TËRHEQJA E MBËSHTETJES PAS KALIMIT TË KËSAJ FAZE nuk mund të sjellë më pasoja në procedurën vijuese parlamentare.”.

Ky është thjesht një mashtrim publik, që vendos në pikëpyetje të fortë kushtetutshmërinë e vendimmarrjes së Gjykatës në rastin konkret.

Grupi Parlamentar i PD-së ka tërhequr mbështetjen në datën 5 dhjetor 2025, përmes shkresës nr. 3853 Prot., datë 05.12.2026. Ndërkohë, Komisioni i Ligjeve ende nuk kishte bërë atë që Gjykata thotë se e kishte bërë: verifikimin e kandidaturave dhe kalimin e tyre për votim në seancë plenare. Verifikimi nga Komisioni i Ligjeve i kandidaturave dhe kalimi i tyre për votim në seancë plenare është bërë në mbledhjen publike të Komisionit në datën 9 dhjetor 2025, pra 4 ditë pas tërheqjes së mbështetjes.

Mashtrimi publik i Gjykatës Kushtetuese për akte dhe fakte që janë të njohura botërisht, lehtësisht të verifikueshme, justifikon edhe arsyet jokushtetuese të Gjykatës Kushtetuese për të mos pranuar kërkesën tonë që çështja të shqyrtohej në seancë plenare publike, transparente dhe që opinioni publik të kishte mundësi të njihej me rrethanat e çështjes.

Një Gjykatë që i shmanget transparencës dhe që mashtron opinionin publik mbi fakte të njohura publikisht, nuk bën drejtësi, por politikë. Kjo është thjeshtë e papranueshme për një shtet ligjor!

TAG:

Avokati i popullit

kërkesa e pd

Reagon bardhi

Të ngjashme



EMRAT/ Caktohen gjyqtarët e Apelit për ish-krerët e UÇK-së



Kushtetuesja rrëzoi kërkesën e PD për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, Shabani: Vendimi i jep përgjigje çdo pikëpyetjeje mbi procedurën zgjedhjes



“Revolucioni i Flamingove”, Rama: Duas i pëlqen protesta, mua më pëlqen Dua

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION **DOSJE ROZË**
KRYESORE POLITIKË **EKONOMI**
ANALIZË RAJON **KULTURË** **SPORT**

e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.